VENDIM
Nr.981, datë 1.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA HYRËSE, BERAT" (SHTESAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga hyrëse, Berat" (shtesat).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 279 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) m^2, tokë truall, të vlerësuar me çmimin prej 3 100 (tre mijë e njëqind) lekë/m^2, me vlerë të përgjithshme 864 900 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 864 900 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind) lekësh, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 263 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.1.2011 dhe të përfundojë më 1.4.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra e Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Berat, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE, TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE

BERAT

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr.Pas.	Lloji i Pas.	Sip. Shpron. (m^2)	Çmimi Lekë/m^2	Shuma lekë	Shuma Totale lekë	Shënime
1	Nexhmedin	Sulejman	Malasi	8501	2/170	Truall	30	3100	93 000	93 000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Nexhmedin	Sulejman	Malasi	8501	2/12	Truall	170	3100	527 000	527 000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Çelnik	Hetem	Shuli	8501	2/172	Truall	79	3100	244 900	244 900	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Shuma						**279**		**864 900**	**864 900**	